



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 715/Prot.

Tiranë, më 03/05 /2019

V E N D I M

Nr. 15 datë 03.05.2019

**“PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË KRIJIMIT DHE ORGANIZIMIT TË STRUKTURES SË POSACME TË UPT, QE DO TË KRYEJE FUNKSIONET E OFRIMIT TË SHERBIMEVE TË SPECIALIZUARA”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 18.7.2002 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pikës 1 të vendimit nr.1055, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr.188, datë 13.03.2019 “Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit te sherbimeve, ne perputhje me veprimtarine e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varesi te tyre”,

V E N D O S I:

1. Të miratojë fillimin e procedurës ligjore për krijimin e strukture së posacme të UPT si nje njesi e specializuar e ofrimit të sherbimeve të ekspertizave të cilat pershihen në fushen e UPT, në kuader të VKM 188/2019.
2. Administrata të paraqese brenda dates 13 Maj 2019 informacionin e percjelle nga secila njesi kryesore e UPT mbi fushat e ekspertizes dhe veprimtarise, dhe personelin akademik qe do të perfshihet në ofrimin e tyre prane strukture së posacme.
3. Rektorati në perputhje me propozimet e njesive kryesore dhe njesive baze të UPT, të organizoje angazhimin e studenteve prane kesaj strukture të posacme sipas degeve dhe fushave të studimit, në sherbimet qe do të ofrohen nga struktura e posacme.
4. Administratori, Rektori si dhe njësitë kryesore të Universitetit Politeknik të Tiranës, të angazhohen për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Kryetar

Arben DHIMA



Alba Thoma

Arjan Beqiraj

Irida Vejsiu

Jonida Teta